



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenin 18 paragrafi 4, 8 dhe 12 të Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenin 26 të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.12.2011, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit** në rastin nr. AKK-03-3142/11, për z. **Qemail Mustafa** – Kryetar i Komunës së Gjilanit.
- II.** Agjencia do të kërkojë fillimin e Procedurës për Kundërvajtje nga Gjykata kompetente.
- III.** Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik nr. 04/L-051, neni 18 paragrafi 1 dhe 3, si dhe në bazë të Vendimit nr.01-3252/11, është hapur rasti nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi për Zyrтарin e Lartë, Qemail Mustafa – Kryetar i Komunës së Gjilanit. Me datën 15.07.2011 Zyrtari të Lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese me të cilën Agjencia ka njoftuar zyrtarin se ka filluar hetimin lidhur me dyshimin e bazuar për situatën Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik. Pas kësaj shkrese Zyrtari i Lartë është paraqitur në Agjenci dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë ka ballafaquar faktet. Në këtë takim është konstatuar me prova zyrtare të marra nga ARBK-ja se Zyrtari i Lartë, Qemail Mustafa është një prej pronarëve të biznesit privat “Frutta Viva“ Sh.p.k., ndërsa në situatë Konflikt interesi me funksionin e tij publik si Kryetar Komune, e sjell funksioni i tij si person i vetëm i autorizuar i biznesit të përmendur. Zyrtari i Lartë në këtë takim është këshilluar nga Zyrtarët e Agjencisë për mënyren se si duhet parandaluar situatën e konfliktit të interesit në të cilën ai ndodhej. Por edhe përkunder afatit të dhënë ligjor nga Agjencia, Zyrtari i Lartë nuk ka ndërmarr asnjë veprim që të parandalojë këtë situatë, prandaj me datën 17.11.2011, i është bërë

shkresa e dytë me të cilën nga Zyrtari i Lartë është kërkuar që brenda afatit të dhënë ligjor të ndryshoi këtë gjendje. Edhe pas këtij afati Zyrtari i Lartë nuk është përgjegjues me asnjë veprim të bërë për të ndryshuar situatën me konflikt interesi, në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (Nr.04/L-051) Neni 20, pika 1, “Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, kur nuk paraqet vepër penale, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë sipas kufijëve të përcaktuar në paragrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3”.

Sipas Nenit 20 pika 2, “Për shkelje të detyrimeve të përcaktuara me këtë ligj, zyrtarit të lartë publik, udhëheqësit apo drejtuesit të institucionit udhëheqës, përveç dënimit gjykata mund t’i shqiptoj edhe masën mbrojtëse; ndalimi i ushtrimit të funksionit publik në kohëzgjatje prej tre (3) muaj deri në një (1) vit.

III. Sipas Nenit 18 paragrafi 12, të gjitha Vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në web faqen zyrtare të Agjencisë.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

